



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e Komisionerit në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

- Duke njohur përpjekjet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

- Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë detyrë për të realizuar reformën në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për vitin 2018 në drejtim të:

- Punës së kryer për realizimin e detyrës, në lidhje me administrimin e të dhënave dhe koordinimin e veprimtarisë midis njësive përgjegjëse, të institucioneve me tipologji të ndryshme në fushën e shërbimit civil, për të rritur nivelin e zbatimit të ligjit në procesin e rikthimit në punë të nëpunësve gjyqfitues.

- Rritjes së nivelit të bashkëpunimit me Departamentin e Administratës Publike, duke diskutuar dhe identifikuar probleme në aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim evidentimin dhe propozimin e zgjidhjeve ligjore të rasteve kur legjislacioni i posaçëm duhet të harmonizohet me legjislacionin për shërbimin civil.

- Mbështetjes së njësive përgjegjëse, gjatë procesit të hartimit të strukturave organizative në njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet këshillimit dhe ofrimit të asistencës teknike në

drejtim të vendosjes së standardeve, në funksion të krijimit të strukturave organizative të qëndrueshme, efikase dhe në përputhje me skemën e administrimit të shërbimit civil.

- Ndjekjes me përparësi të procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese nga ana e institucioneve të mbikëqyrura/inspektuara.

- Finalizimit të procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore/61 bashki, i cili ka nisur në vitin 2015 dhe konstatimit të problemeve që evidentojnë gjendjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në këto subjekte në momentin e kontrollit.

- Mbikëqyrjes së procesit të rekrutimit, të realizuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe institucione të tjera që punësojnë nëpunës civilë, duke konstatuar probleme, në veçanti për administratën vendore, sidomos në drejtim të parregullsive të lejuara gjatë realizimit të procedurave të rekrutimit me grup pozicionesh dhe mosrespektimit të parimit të meritës gjatë procesit të konkurrimit.

- Forcimit të bashkëpunimit të nisur me të gjitha institucionet, të cilat, për shkak të kompetencave që u ka ngarkuar ligji i posaçëm, ushtrojnë ndikim në administrimin e shërbimit civil në nivelin e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

Kuvendi kërkon që Komisioneri, për vitin 2019, të angazhohet në këto drejtime:

- Të përmbyllen veprimet për administrimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, me qëllim që të evidentohen arsyet që pengojnë ecurinë e këtij procesi dhe të vijojë procesi i hetimit administrativ në lidhje me rastet individuale, të konstatuara në shkelje të ligjit, në fazën e parë të procesit.

- Të koordinojë veprimtarinë me Departamentin e Administratës Publike dhe njësitë përgjegjëse të institucioneve të administratës vendore dhe atyre të pavarura, me qëllim që të identifikohen mundësitë e sistemimit të punonjësve gjyqfitues në shërbimin civil, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor.

- Të nxitet niveli i bashkëpunimit midis Komisionerit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit në drejtim të zbatimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, me qëllim që të reduktohen kostot financiare në buxhetin e shtetit.

- Të vijojë mbikëqyrja e orientuar drejt procedurave të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për kategorinë ekzekutive, të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues dhe procedurave të pranimit në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND) pranë Departamentit të Administratës Publike, duke i kushtuar një vëmendje të posaçme edhe rekrutimit në administratën vendore.

- Të realizojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë, nga ana e institucioneve të mbikëqyrura/inspektuara, si dhe të përmbyllë proceset e nisura, të cilat nuk janë finalizuar, duke informuar vazhdimisht për ecurinë Kuvendin.

- Të vijojë procesin e nisur, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, për trajnimin e njësisive të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën lokale, me qëllim unifikimin e zbatimit të ligjit, duke respektuar afatet e vendosura në planin e veprimit për realizimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP).

- Të shqyrtojë me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare.

- Të monitorojë sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore për njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim ndalimin e përdorimit të detyruar të nëpunësve civilë në fushatën zgjedhore, gjatë orarit zyrtar, nga subjektet politike, e po kështu edhe mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave të tyre me karakter politik, si dhe respektimin nga ana e tyre, të kufizimeve që ligji i ka vendosur në lidhje me këto të drejta.

Miratuar në datën 25.4.2019